

V E N D I M
Nr.247, datë 25.5.1995

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.140, DATË
22.3.1995 “PËR REGJISTIRMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe Ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.140, datë 22.3.1995 shtohet një kapitull me këtë përmbajtje:

“IV- Financimi

Për nxjerrjen dhe plotësimin e listave të pensionistëve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i akordohen 6 milionë lekë, nga të cilët 3 milionë lekë do të përdoren për shpërblimin e punonjësve të përhershëm që do punojnë mbi kohën normale të punës, dhe 3 milionë lekë fond pagë për aktivizimin e punonjësve të tjerë, provizorë, të cilët do të përballohen brenda buxhetit të miratuar për këtë institucion”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi